



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

VU644-24-1466-1-2-1/C989

14 Nr. 1040/24

Dt. 05.12.2024

KONTRATË

1. Komuna e Vushtrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi– Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**), dhe
2. **" INFINITT " SH.P.K., Dëshmorët e Kombit, PRISHTINË, me ARBK 810355215** (në vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Nr1 i prokurimit	VU644-24-1466-1-2-1
Nr i brendshëm	VU644-24-013-121

LOT 2 Furnizimi dhe Instalimi i Projektorëve dhe Mbajtësve për Projektor

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **40** nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **10** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë **Ne depo te shkollave**.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë **DDP (Të gjitha detyrimet Doganore\tatimore të paguara)**.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **12,374.90€**; [*Dymbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër € 90\100 eurocent*] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

Nuk lejohen ndryshimet-modifikimet.

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim:

Nuk lejohen ndryshimet-modifikimet.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pasi që Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues dhe Komisioni i Pranimit të mallit të A.K. të konfirmoi me shkrim pranimit- dorëzimin e aparateve, respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se pajisjet janë dorëzuar – pranuar nga personat kompetent në institucionin në fjalë, si në aspektin sasior ashtu dhe në aspektin cilësor. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i Pranimit të Mallit do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimet dhe / ose shërbimet e përfunduara.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve dhe / ose shërbimeve është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisjet e dorëzuara duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojnë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni për cilësinë e mallit do të mbetet përgjegjësi e furnizuesit. Kontraktuesi duhet të dorëzojë Deklaratën me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur për garancionin e kualiteti të kontratës për periudhën e kohëzgjatjes prej 36 muaj nga data e dorëzimit të mallit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj *kompensimeve* tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve dhe / ose shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Neni 15 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

15.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 16 Komunikimet

16.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

16.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

16.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

16.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Ilmi Azemi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	06/12/2024
Vula:	



Për Furnizuesin

Emri:	ASTRIT UKA
Pozita:	MANAHER
Nënshkrimi:	
Data:	06/12/2024
Vula:	



³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Shënimi1: Te përshkrimi i grimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G									
Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0% , 8% apo 18% ,									
kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presëjes dhjetore									
Ndërsa në									
Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
1	Projektor - Resolurion Native WXGA (1280x800) Aspect Ratio 16:10 Color/White Brightness: 3,000/3,000 lumnes Lamp Life (Normal Mode) Up to 6,000 hours, ECO Mode Up to 12,000 hours Throw Ratio Range 1.27-1.71 Color Reproduction UP to 16.8 million colors Keystone Correction (Vertikal) and (Manual Horizontal) ±30 degrees Speaker 5W Interface: HDMI, USB - Type A Projection Method Front/rear/ceiling mount Remote Control	Copë	40	233.90	18.00	276.00	9,355.93	1,684.07	11,040.00
2	Mbjatse për projektor në tavan, montues universal, me distanc nga tavani së paku 20 cm i cili lejon pjertësi deri 15 shkallë dhe rrotullim deri 180 shkallë.	Copë	30	10.93	18.00	12.90	327.97	59.03	387.00
3	10 Meter Kablo HDMI per projektor	Copë	35	7.80	18.00	9.20	272.88	49.12	322.00
4	10 Meter Kablo e rrymës elektrike, standard tri polëshe për projektor me gjithë spin (mashkull)	Copë	29	8.05	18.00	9.50	233.47	42.03	275.50
5	Kanale plastike per vendosjen e kabllave	m'	151	0.76	18.00	0.90	115.17	20.73	135.90
6	Konvertues nga HDMI në VGA	Copë	33	5.51	18.00	6.50	181.78	32.72	214.50
TOTALI I PËRGJITHSHEM ME TVSH:							10,487.20	1,887.70	12,374.90

Numri i prokurimit: VU644-24-1466-1-2-1 apo nr. i brendshem: VU644-24-013-121 Titulli: LOT 2 Furnizimi dhe Instalimi i Projektoreve dhe Mbjetesve per Projektor

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	INFINITT SH.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PERFAQESUESIT TE OE:	Astrit Uka- menaxher
NENSHKRIMI:	
DATA:	25.03.2024.
VULA:	